

LIGJ
Nr. 34/2023

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9584, DATË 17.7.2006, “PËR PAGAT,
SHPËRBLIMET DHE STRUKTURAT E INSTITUCIONEVE TË PAVARURA
KUSHTETUESE DHE TË INSTITUCIONEVE TË TJERA TË PAVARURA,
TË KRIJUARA ME LIGJ”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Pika 1 e nenit 2 ndryshohet si më poshtë:

“1. “Institucione kushtetuese dhe institucione të tjera të pavarura, të krijuara me ligj” janë: institucioni i Presidentit, Kuvendi, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Autoriteti i Konkurrencës, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Instituti i Statistikave dhe Autoriteti i Mediave Audiovizive.”.

Neni 2

Lidhja nr. 1 zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 3

Dispozita të fundit

1. Në nenin 13, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, fjalët “257 000 lekë në muaj” zëvendësohen me fjalët “425 000 lekë në muaj”.

Neni 4

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë, i shtrin efektet financiare nga data 1 prill 2023 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 25.5.2023.

Shpallur me dekretin nr. 74, datë 29.5.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

RAPORTET E PAGAVE

A

Nr.	Funksioni	Raporti
1	Kryetari i Kuvendit	0,925
2	Kryeministri	0,925

B

Nr.	Funksioni	Raporti
1	Zëvendëskryetari i Kuvendit	0,775
2	Zëvendëskryeministri	0,775

C

Nr.	Funksioni	Raporti
1	Ministri	0,750

D

Nr.	Funksioni	Raporti
1	Deputeti	0,730

E

Nr.	Funksioni	Raporti
1	Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave	0,700

F

Nr.	Funksioni	Raporti
1	Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil	0,600
2	Kryetari i Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës	0,600
3	Kryetari i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare	0,600
4	Kryetari i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura	0,600
5	Kryetari i Autoritetit të Mediave Audiovizive	0,600
6	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale	0,600
7	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	0,600
8	Kryetari i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit	0,600
9	Drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Statistikave	0,600

G

Nr.	Funksioni	Raporti
1	Anëtarët e Komisionit të Konkurrencës	0,450
2	Anëtarët e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare	0,450
3	Anëtari i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura	0,450
4	Zëvendëskryetari i Autoritetit të Mediave Audiovizive	0,450
5	Anëtarët e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit	0,450